



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 17, datë 20.02.2017

Për

“SHPREHJEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURISË ME NR. 745 DHE 744/2 TË LLOJIT “PYLL” NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE, PETRELË”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenit 27, pika 5, nenit 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 për “Ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 për “Pyjet dhe shërbimin pyjor” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 për “Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 për “Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”; Shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik nr.prot. 35697/3, datë 19.12.2016; Shkresës së Zyrës Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nr.prot. 1625, datë 25.01.2017(Protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr.prot. 2303/2 datë 27.01.2017), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Tiranë,

V E N D O S I:

1. Të japë pëlqimin në parim për dhënien me qira për pasuritë si më poshtë, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:
 - Pasuria me nr. 745, volum 3, faqe 85, zonë kadastrale nr.3091, lloji i pasurisë “Pyll”, në pronësi shtet sipas kartelës së lëshuar nga ZVRPP dhe genplanit bashkëlidhur.

- Pasuria nr. 744/2 në volum 4, faqe 149, zonë kadastrale 3091, pasuri e llojit “Pyll”, në pronësi të shtetit pa përfshirë sipërfaqen me objekte referuar konfirmimit të ZVRPP Tiranë dhe në genplanin bashkëlidhur.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 për “Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit pyjor .
 3. Për pasurinë me nr. 744/2, procesi i përcaktuar në pikën 2 të këtij projekt-vendimi të kryhet vetëm pasi pasuria me nr. 744/2 të jetë ndarë hartografikisht duke identifikuar dhe përjashtuar sipërfaqën e zënë me objekte.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit.
 5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI